



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:217413
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05633448

Ac.nr.6065/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit dhe Malsor Kryeziu e Fatmir Baloku - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Ndërmarrja Publike Banesore me seli në Prishtinë, Rr. “Bill Kllinton” pn, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.K. – jurisë pran të paditurës, kundër të paditurit A.A. nga fshati S, Komuna Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.C., avokat nga Prishtina, për shkak të pagimit të borxhit për qira, duke vendosur sipas ankesës të paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.1368/19 të datës 16.10.20219, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si e bazuar ankesa e paditësit Ndërmarrja Publike Banesore me seli në Prishtinë, **PRISHET**, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr. 1368/19 të datës 16.10.2019, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me aktgjykimin C.nr. 1368/19 të datës 16.10.2019, ka vendosur si vijon:

I.REFUZOHET padia dhe kërkesëpafia e paditëses Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri A.A. nga fshati S, Komuna Podujevë, që paditëses në emër të qirasë për lokal in afarist që gjendet në Prishtinë, Rruga ..., lokali nr...., në sipërfaqen prej 67.21 m2, për periudhën 05.10.2001 deri më 05.08.2008, t’ia paguaj shumën prej 23,574.78 €, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, si e pabazuar.

II. Detyrohet paditësja Ndërmarrja Publike Banesore (NPB), me seli në Prishtinë që të paditurit A.A. nga fshati S, t'ia paguaj shpenzimet procedurale, ne shumën prej 540.80 €, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes-plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi Ndërmarrja Publike Banesore me seli në Prishtinë, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore,
- Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, ankesën e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në pajtim me nenin 194 të LPK-së, në kuadër të kufijve të pretendimeve ankimore dhe duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së, të parapara me nenin 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri t'ia paguaj në emër të qirasë për lokalin afarist që gjendet në Prishtinë, rruga Ulpiana, lokali nr.26/6, në sipërfaqe prej 67,21m², për periudhë prej 05.10.2001 deri më 05.08.2008, t'ia paguaj shumën prej 23.574,78€, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë ka marr aktgjykimin më afër të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, duke gjetur se në mes palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese se kanë lidhur kontratën për qira me datë 27.02.2001 dhe i padituri ka marrë në posedim lokalin, ndërsa me datë 26.12.2006 kanë lidhur kontratën nr.03-2413/1, për lokalin si më lartë për periudhën prej 31.07.2006 deri me 31.12.2006. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqës ka qenë fakti se i padituri e kishte borxhin e pretenduar në emër të shfrytëzimit të lokalit lëndor për qira apo i njëjti hynë në kategorinë e faljeve të borxheve ndaj Ndërmarrjeve publike siç parashihet me nenin 4 të Ligjit për faljen e borxheve publike. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar nga njoftimi nr.03-2164/1 të datës 16.10.2007 se i padituri i ka përmbushur obligimet financiare në tërësi ndaj qiramarrësit, ashtu që paditësja ka shfuqizuar njoftimin nr.03/20431/1 të datës 20.09.2007, ndërsa ka lënë në fuqi kontratën për qiranë e lokalit afarist nr.2413/1 të datës 26.12.2006. Poashtu gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike kemi të bëjmë me parashkrimin e tërësishëm të kërkesës së paditësit e në kuptim të nenit 375 të LMD-së.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n). Njëherit edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, përkatësisht në mënyrë jo të plotë, e që për pasoj ka pasur edhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, prandaj edhe detyrimisht është dashur të aprovohet ankesa dhe vendimi i goditur të priset në tërësi.

Në fakt dispozitivi i aktgjykimit të goditur është kundërthënës dhe në të nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare për një vendim të drejtë e të ligjshëm ngase në arsyetim tregohet se i padituri ka përmbushur borxhin në tërësi e nga ana tjetër gjithashtu në arsyetim gjykata e shkallës së parë tregon se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar në tërësi. Pra, siç u tha më lartë gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të goditur tregon se i padituri ka përmbushur obligime financiare në tërësi ndaj qiramarrësit e duke u bazuar në njoftimin nr. 03-2164/1 të dt. 16.10.2007. Më tej gjykata e shkallës së parë pretendon se ka vlerësuar me kujdes theksimet e palës së paditur lidhur me afatet e parashkrimit dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me parashkrimin e tërësishëm të kërkesës së paditësit në pajtim me dispozitën e nenit 375 të LMD-së, në të cilën është paraparë se kërkesa e qirasë si për atë që është caktuar të paguhet periodikisht ashtu edhe për atë që është caktuar të paguhet në shumë totale, parashkruhet për 3 vjet. Përfundimisht për gjykatën e shkallës së parë për rastin konkret e që lidhet me borxhin në shumë prej 23.574,78 €, për periudhën 05.10.2001 deri me 05.08.2008, rrjedh të jetë i parashkruar pasi që padia për pagesën e qirasë në gjykatë është parashtruar me dt.27.04.2006.

Mirëpo gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka pasur parasysh njoftimin e dt. 16.10.2007, me të cilën pohohet se i padituri deri në këtë datë ka përmbushur detyrimin e vet ndaj paditësit, mirëpo nuk ka pasur parasysh faktin se kërkesëpadia e paditësit ka qenë për periudhën kohore nga data 05.10.2001, e deri më dt. 05.08.2008, e që nënkupton edhe pas datës 16.10.2007 dhe në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se pas datës 16.10.2007 e deri më dt. 05.08.2008 i padituri a ka pasur borxh, përkatësisht a ka pasur të përmbushur detyrimin deri me këtë datë.

Njëherit gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme në drejtim të parashkrimit të kërkesës, sepse gjykata e shkallës së parë sipas vlerësimit të kësaj gjykate gabimisht ka bërë përllogaritjen e parashkrimit të kërkesës. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka pasur parasysh faktin se kërkesëpadia e paditësit ka të bëjë për periudhën kohore 05.10.2001 e deri me dt. 05.08.2008, si dhe faktin tejet me rëndësi se paditësi në gjykatë ka ushtruar padi me datë 27.04.2006, me ç rast sipas dispozitave ligjore ka ardhur deri te ndërprerja e parashkrimit, andaj konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se borxhi i kërkuar me padi është parashkruar tani për tani është e paqëndrueshme sepse gjykata e shkallës së parë siç u cek edhe më lart nuk ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare lidhur me ekzistimin e parashkrimit pasi që padia është ngritur me 27.04.2006, ndërsa precizimi i kërkesëpadisë është bërë me dt. 15.01.2015 dhe për faktin e a ekziston borxhi pas datës së njoftimit, përkatësisht 16.10.2007 e deri më 05.08.2008.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë do të ketë parasysh të cekurat si më lart, ashtu që do të vlerësoj se borxhi i të paditurës a është përmbushur në tërësi duke marr për bazë njoftimin të dt. 16.10.2017 dhe periudhën për të cilën kërkohet borxhi, si dhe do të ketë parasysh çështjen e parashkrimit të kërkesës se a është parashkruar në tërësi apo ka ardhur deri te ndërprerja e rrjedhjes së parashkrimit me ngritjen e padisë. Është e udhës që gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes të vendos vetëm nga njëra bazë dhe atë mbi bazën e përmbushjes së kontratës dhe mos ekzistimit të borxhit apo duke u bazuar në bazën e parashkrimit, gjatë vendosjes gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh që aktgjykimi ta ketë një dispozitiv të qartë, jo kontradiktor dhe në arsyetim të jep arsye për faktet vendimtare për një vendim të drejtë e të ligjshëm.

Nga arsyet e cekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 195. par. 1 pika c) të LPK.

Numri i lëndës: 2019:217413
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05633448

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6065/2020 me dt. 18.04.2024

Kryetari i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli